VENDIM
Nr.77, datë 19.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 8.11.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 66 Akti që i përket:

KËRKUES: Shoqëria "Albadita" sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria "Invo-1100" sh.p.k., Ministria e Energjisë dhe Industrisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 1006, datë 24.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2016-107, datë 30.03.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, shoqërisë "ALBADITA" sh.p.k., që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë "INVO-1100" sh.p.k., që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ushtron aktivitet në fushën minerare të nxjerrjes së kromit sipas lejes së shfrytëzimit të dhënë nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë (Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit në kohën kur është dhënë leja). Ajo ka marrë me qira si aset linjën e shkarkimit të mineralit nga shoqëria "Albkrom" sh.a.

2. Subjekti i interesuar, shoqëria "INVO-1100" sh.p.k., ushtron gjithashtu aktivitet në fushën minerare mbi bazën e lejes së shfrytëzimit të dhënë po nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3. Të dyja këto shoqëri ushtrojnë aktivitet mbi një pjesë të dubluar të sipërfaqeve të licencuara. Deri në mesin e vitit 2009 ato kanë punuar normalisht duke shfrytëzuar me radhë pjesën e dubluar të sipërfaqes së shfrytëzimit. Më pas, midis dy shoqërive kanë lindur mosmarrëveshje për sa i përket shfrytëzimit nga kërkuesja të skemës së transportit të marrë si aset nga "Albkrom" sh.a. (në likuidim).

4. Kërkuesja ka pretenduar se shoqëria "INVO-1100" sh.p.k. ka penguar shfrytëzimin e skemës së transportit dhe për këtë arsye ajo i është drejtuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, konkretisht Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Shfrytëzimit dhe Projekteve, për të zgjidhur

mosmarrëveshjen. Në shkresën nr.1244, datë 19.05.2010, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka bërë me dije palët se pas verifikimeve rezulton se është shoqëria "INVO-1100" sh.p.k. që ka punuar duke penguar kërkuesen në skemën transportit, e cila është pjesë përbërëse e lejes së kërkueses. Ministria ka rekomanduar në këtë shkresë ndërprerjen e shfrytëzimit në zonën e dubluar nga subjekti "INVO-1100" sh.p.k. dhe kryerjen e aktivitetit të të dyja subjekteve sipas një aktmarrëveshjeje, duke respektuar rregulloren e sigurimit teknik në miniera. Kjo marrëveshje nuk është arritur, ndaj kërkuesja ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Dibër.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.456, datë 11.7.2011, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e pjesshëm të padisë dhe detyrimin e shoqërisë "INVO-1100" sh.p.k. të shpërblejë kërkuesen për dëmin e shkaktuar në shumën 5.406.069 lekë.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1006, datë 24.04.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.456, datë 11.7.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rrëzimin e kërkesëpadisë, pranimin e kundërpadisë, detyrimin e të padituri kundërpaditës të mos kryejë veprime apo mosveprime që pengojnë ose ndërpresin shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga shoqëria "IVNO-1100" sh.p.k dhe detyrimin e të padituri kundërpaditës t'i paguajë shoqërisë "IVNO-1100" sh.p.k. shpërblimin prej 7.100.000 lekësh për dëmin e shkaktuar.

7. Ministria e Energjisë dhe Industrisë si dhe kërkuesja kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2016-107, datë 30.3.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.1006, datë 24.4.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

II

8. ***Kërkuesja*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Më konkretisht, ajo ka parashtruar se:

8.1 Është cenuar parimi i disponibilitetit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit ka vendosur, ndër të tjera, edhe detyrimin e të padituri kundërpaditës të mos kryejë veprime apo mosveprime që pengojnë ose ndërpresin punimet apo shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga i padituri kundërpaditë, pavarësisht se kjo nuk është kërkuar në objektin e kundërpadisë. Pala e paditur ka kërkuar në kundërpadi shpërblimin e dëmit nga paditësi në masën 7.100.000 lekë, pasi sipas saj paditësi është shkaktar i ndërprerjes së punës në galerinë nr.3 si dhe prishjes së sipërfaqes së tokës sipas hartës topografike.

8.2 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit ka kopjuar tërësisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dispozitivi i këtij vendimi është kontradiktor. Ajo nuk ka arsyetuar se në cilin aspekt ka gabuar gjykata e shkallës së parë, në cilat prova e ka mbështetur ndryshimin e vendimit, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit. Këto shkelje të procesit të rregullt ligjor, të ngritura në rekurs, nuk janë konstatuar dhe as janë korrigjuar nga Gjykata e Lartë. Gjithashtu, në këtë vendim mungojnë përgjigjet për disa nga pretendimet kryesore të ngritura në rekurs.

8.3 Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, për arsye se si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit, kanë arritur në një konkluzion të kundërt me këtë akt ekspertimi të administruar në shkallën e parë dhe nuk kanë kryer një ekspertim të ri. Ky akt ekspertimi, sipas kërkueses, ka qenë prova vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Këto dy gjykata nuk kanë arsyetuar se përse e kanë anashkaluar këtë akt ekspertimi.

9.***Subjekti i interesuar, shoqëria "INVO-1100" sh.p.k.,*** pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesja nuk përmban asnjë element të cenimit të të drejtave kushtetuese për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

9.1 Njëri prej gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka lidhje të ngushta me përfaqësuesin e

kërkueses. Në këto kushte ai duhet të përjashtohet nga gjykimi kësaj çështjeje për njëanshmëri.

9.2 Fakti që gjykatat kanë vlerësuar provat dhe kanë marrë vendim në favor të paditësit/kundërpaditës nuk i bën këto gjykata të njëanshme. Në kërkesën e saj kërkuesja ngre pretendime për vlerësimin e provave, gjë e cila është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

9.3 Gjykatat nuk kanë cenuar parimin e disponibilitetit, siç pretendon kërkuesja, pasi ato kanë vendosur vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve.

9.4 Vendimet e gjykatave janë të arsyetuara dhe të bazuara në dispozitat përkatëse ligjore dhe pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk është i bazuar.

10. **Subjekti i interesuar, Ministria e Energjisë dhe Industrisë**, nuk ka sjellë pretendime në lidhje me çështjen objekt kërkese.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

11. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata)* vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimimit të kërkueses për pretendimet e ngritura në kërkesë.

12. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Po ashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej saj në kërkesë *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të disponibilitetit dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Apelit

13. Sipas kërkueses është cenuar parimi i disponibilitetit në gjykim, pasi Gjykata e Apelit ka vendosur, ndër të tjera, edhe detyrimin e të padituri kundërpaditës të mos kryejë veprime ose mosveprime që pengojnë apo ndërpresin punimet ose shfrytëzimin e galerisë nr. 3 nga i padituri kundërpaditës, pavarësisht se kjo nuk është kërkuar në objektin e kundërpadisë.Gjithashtu, kërkuesja pretendon se është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Gjykatës së Apelit ka kopjuar tërësisht vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe dispozitivi i këtij vendimi është kontradiktor. Ajo nuk ka arsyetuar se në cilin aspekt ka gabuar gjykata e shkallës së parë, në cilat prova e ka mbështetur ndryshimin e vendimit, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ankimit.

14. Sipas nenit 131/f të Kushtetutës individi mund t`i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr.3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese.

15. Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion

subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr.28, datë 23.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Shqyrtimi kushtetues i kërkesave individuale udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr.19, datë 2.4.2012; nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (shih vendimin nr.31, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese, si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata, duke shqyrtuar materialet e dosjes gjyqësore, konstaton se kërkuesja pretendimet e saj për cenimin e parimit të disponibilitetit dhe të arsyetimit të vendimit gjyqësor, nuk i ka ngritur në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, duke mos shteruar mjetet për t'iu drejtuar kësaj gjykate.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim

18. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim, për arsye se si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk e kanë marrë parasysh aktin e ekspertimit, kanë arritur në një konkluzion të kundërt me këtë akt ekspertimi të administruar në shkallën e parë dhe nuk kanë kryer një ekspertim të ri. Ky akt ekspertimi, sipas kërkueses, ka qenë prova vendimtare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe vetëm fakti që është i administruar në dosje nuk mjafton për të vlerësuar se është marrë si provë nga Gjykata e Apelit. Si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar se përse e kanë anashkaluar këtë akt ekspertimi duke e vendosur kërkuesen në disavantazh me palën tjetër.

19. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr.34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre janë në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren, dhe mënyra e vlerësimit, si dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr.2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet dhe komentet e palës tjetër, e bën procesin gjyqësor të cenueshëm. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr.17, datë 18.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të

barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe i mundësisë për të dhënë argumentet e tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr.34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesja ka qenë e pranishme gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit dhe ka pasur mundësi të paraqesë pretendimet e veta në seancë gjyqësore. Po kështu, edhe në Gjykatën e Lartë ajo ka paraqitur rekurs, ku ka parashtruar të gjitha pretendimet e saj. Pra, kërkueses nuk i është mohuar e drejta për të paraqitur përpara gjykatave çështjen e saj. Argumentet e kërkueses për të justifikuar cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim lidhen me vlerësimin e gjykatës për sa i përket provës që ajo e konsideron si vendimtare në proces. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 4, datë 5.2.2014; nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkueses është i pabazuar.

23. Nisur nga sa më lart, Gjykata në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtar kundër: Vitore Tusha